



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA			
Njësia: Unit:	KL	Nr. Prot.: Prot. No.:	1067
Jedinita: No. of pages:	2	Br. Prot.: Date:	12.06.2019
Br. stranica:		Datum: Prishtinë/à	KEVP - KL

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

PËR: Mjekët me Specializime të shumëfishta

CC: Dr. Basri Sejdiu, Drejtor i Përgjithshëm SHSKUK
Drejtorët e Klinikave, Qendra Klinike Universitare e Kosovës
Drejtorët e Spitaleve Rajonale
Drejtorët e Qendrave Kryesore të Mjekësive Familjare
Drejtorët e Institucioneve Private Shëndetësore

NGA: Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional i OMK-së dhe
Komisioni për Licencim i OMK-së

LËNDA: Qarkore informative lidhur me procesin e Ri-Licencimit për mjekët që posedojnë
Licenca të punës me dy apo më shumë thirrje specialistike

DATE: 12.06.2019

Të nderuar,

Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional (KEVP) dhe Komisioni për Licencim (KL) i Odës së Mjekëve të Kosovës, me bartjen e kompetencave publike nga Ministria e Shëndetësisë kanë udhëhequr, ndër të tjera, me procesin e Ri-Licencimit të mjekëve që ushtrojnë veprimtrinë e tyre brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Gjatë këtij procesi, kemi hasur në pranimin e aplikacioneve për rilicencim nga mjek me specializime të shumëfishta të cilët në Licencën e tyre të punës, të lëshuar nga organi paraprak kompetent për rilicencimin e mjekëve, kanë të shënuar më shumë se një thirrje specialistike.


Fillimisht ju sqarojmë se Rregullorja për Regjistrimin, Licencimin dhe Rilicencimin e mjekëve e OMK-së, e datës 17 janar 2019, në Nenin 25, Paragrafi 1 dhe 2, thekson se i licencuari i cili ka specializuar në më shumë se një lëmi specialistike apo subspecializime, për secilin specializim i lëshohet licencë e veçantë e punës dhe licencat si të tilla janë dokumente të veçanta për të cilat poseduesi ka përgjegjësi për secilën nga to.

Kjo nënkupton se me rastin e inicimit të procedurës për Ri-Licencim pranë Odës, specializimet do të trajtohen si të ndara, rrjedhimisht për secilin specializim ju duhet të grumbulloni 100 (njëqind) pikë kredituese dhe për secilin specializim do ju lëshohet licencë e veçantë e punës.

Ju lutem që këtë qarkore të e shpërndani pranë institucionit tuaj.

Me respekt,

Kryetari i Komisionit për EVP
Prof.Ass.Dr. Shemsedin Sadiku



Kryetari i Komisionit për Licencim
Prof.Assoc.Dr. Ibrahim Rudhani

